



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

REKTORE

Nr 1359 prot.

Shkodër, më 19/04/2021

URDHËR

Nr. 138, datë 19.04. 2021

"Mbi miratimin e Programit të Transparencës së Rishikuar në USH"

Në zbatim të nenit 5 të Ligjit me Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të Urdhërit Nr. 187, datë. 18. 12. 2020 "Për miratimin programit të transparencës të rishikuar" dhe Urdhërit Nr. 188, datë. 8. 12. 2020 "Për miratimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve të rishikuara" publikuar në fletoren zyrtare Nr. 224, datë. 22. 12. 2020, si dhe shkresës me Nr. 274/43, datë. 05. 02. 2021 të Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

MIRATOJ:

1. Programin e transparencës së Universitetit të Shkodrës, të rishikuar, në kuadër të detyrimeve që vijnë nga ligji për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
2. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohen , Koordinatorët për të drejtën e informimit në USH dhe Specialisti i IT i USH-së.
3. Këtij urdhëri i bashkangjitet Programi i Transparencës së Universitetit të Shkodrës, i rishikuar.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORE
Prof. Dr. Suzana GOLEMI